



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 49/2012
Prishtinë, më 14.02. 2012, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK, INFRASTRUKTURË,
TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Zenun Pajaziti - kryetar, Teuta Sahatqija, Fikrim Damka, Sala Berisha – Shala, Lutfi Zharku, Visar Ymeri, Myzejene Selmani, Berat Buzhala, Ramiz Kelmendi, Biserka Kostiq dhe Muhamet Mustafa - anëtarë të Komisionit për Buxhet dhe Financa.

Munguan: Hashim Deshishku.

Pjesëmarrës të tjerë: Ahmet Krasniqi- AKK- Ukë Gashi - ZRPK; Haxhi Gashi – USAID/ Deloitte dhe Florije Mehmeti –KDI.

Stafi mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Muhamet Morina, Besim Haliti, dhe Brikena Hoxha- konsulente e Komisionit.

Mbledhjen e kryesoi, Zenun Pajaziti - kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 07.02.2012;
3. Shqyrtimi i Projektstatutit të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës;
4. Shqyrtimi i Raportit për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për shpronësimin e pronës së paluajtshme;
5. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 07.02.2012

Procesverbali nga mbledhja e datës 07.02.2012 u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektstatutit të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës

Kryetari – Tha se për këtë pikë të rendit të ditës kemi një raport nga grupi i punës, por që ka nevojë të shqyrtohet ende, sepse nuk ka arritur t'i shqyrtojë të gjitha nenet për arsye të disa vështirësive që kanë hasur në të dhe e kanë sjellë përsëri në Komision, që ne sot t'i shqyrtojmë ato nene ku janë më problematike në aspektin e vendimmarrjes. Kërkoj nga kryesuesja e grupit të punës që ta prezantojë punën e këtij grupi, deri ku ka arritur ta shqyrtojë Projektstatutin e Autoritetit Kosovar të Konkurrencës.

Sala Berisha – Shala – Theksoi se grupi i punës nuk ka arritur të shqyrtojë gjithë materien e Projektstatutit të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës. Harmonizimin e kemi bërë deri tek neni 12. Këtu janë paraqitur dy propozime: njëri propozim është drafti i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës dhe tjetri është i propozuar nga Zyra mbështetëse e Komisionit, në bashkëpunim me grupin e punës dhe kërkoj nga deputetët që të diskutohet vetëm për vërejtjet për të cilat ata kërkojnë sqarime apo plotësim-ndryshime.

Lutfi Zharku – Propozoi që te neni 7, të fuzionohen pikat 4 dhe 7, ndërsa të hiqen pikat 10, 12 dhe 13; te neni 12 propozoi që të ketë vetëm “sekretar të Komisionit”, e jo siç është “sekretar i përgjithshëm” dhe të kemi vetëm dy departamente, si: departamenti i mbikëqyrjes së tregut dhe departamenti juridik dhe i administratës; te neni 11, propozoi të hiqet paragrafi 2, ndërsa në paragrafin 3, në vend të “anëtarët e Komisionit” të jetë “kryetari”; te neni 13, propozoi të shtohet pika “përfaqëson Autoritetin dhe menaxhon me punën e tij” dhe paragrafi 4 të hiqet; te neni 14, propozoi të hiqen paragrafët 3 dhe 5. Gjithashtu, propozoi të hiqen nenet e propozuara: 15, 16, 17 dhe 18; te neni 26, të hiqet paragrafi 3.

Myzejene Selmani – Theksoi se duhet të hiqen nenet, që janë marrë komplet nga ligji, për shkak se s'ka nevojë të ketë dublikim të normave.

Visar Ymeri – Theksoi se duhet të kemi kujdes se si po e cilësojmë apo si po e konsiderojmë Komisionin e Konkurrencës, që menaxhon si trup i përbashkët, apo t'i japim kompetenca më të gjëra kryetarit të këtij Komisioni apo Autoriteti. Ai bëri thirrje që këtë çështje të shtrojmë qartë në harmonizim të plotë me ligjin dhe frymën e ligjit.

Ramiz Kelmendi – Theksoi se, sa i përket Nenit 10, duhet të kemi kujdes që mos të koncentrojmë kompetenca në shumë degë apo departamente, sepse po shkaktojmë shpenzime të mëdha dhe të panevojshme. Po ashtu, propozoi që te neni 11, “zëvendëskryetari i Komisionit” të caktohet nga kryetari dhe t'i mbetet kompetencë kryetarit se kush ta zëvendësojë.

Kryetari – Kërkoj nga njësia mbështetëse e Komisionit që t'i inkorporojë të gjitha plotësim-ndryshimet që u diskutuan dhe të bëjë harmonizime me ligjin dhe të rregullojë teknikisht Statutin.

Pas debatit, Komisioni unanimitet nxori këtë

Përfundim

Miratohet Projektstatuti i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës.

Vendosi që Kuvendit të Republikës së Kosovës t'ia paraqesë këtë

R e k o m a n d i m

Të miratohet Statuti i Autoritetit të Konkurrencës të Kosovës.

4. Shqyrtimi i Raportit për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për shpronësimin e pronës së paluajtshme

Kryetari – Tha se për këtë pikë të rendit të ditës, grupi i punës ka hartuar Raportin për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për shpronësimin e pronës së paluajtshme dhe kërkoj nga deputetët tjerë të Komisionit, nëse kanë ndonjë sugjerim apo vërejtje, le t'i paraqesin për t'i diskutuar.

Muhamet Mustafa – Fillimisht, falënderoi grupin e punës që ka bërë një punë të mirë dhe një raport shumë të mirë. Ndërsa, lidhur me rekomandimet të cilat i përkrahu, propozoi edhe një rekomandim si në vijim:

“Ministritë përkatëse dhe komunat që në fillim të procedurave të shpronësimit të zhvillojnë konsultime paraprake me komunitetin që tangojnë nga shpronësimet, duke u bazuar në standardet dhe përvojat ndërkombëtare”.

Pas debatit, Komisioni unanimitet nxori këtë

Përfundim

Miratohet Raporti për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për shpronësimin e pronës së paluajtshme.

Vendosi që Kuvendit të Republikës së Kosovës t'ia paraqesë këto

Rekomandime

1. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Ministria e Financave të nxjerrin aktet e nevojshme nënligjore, në afatin prej gjashtë (6) muajsh nga miratimi i këtyre rekomandimeve.
2. Organi shpronësues, Qeveria dhe komunat, duhet të bëjnë studime të hollësishme dhe të kujdesshme, sikurse kërkohet nga Ligji për të provuar që, qëllimi i shpronësimit është i ligjshëm e publik.

3. *Organi shpronësues, Qeveria dhe komunat, duhet të jenë më transparente në nxjerrjen e vendimeve për shpronësim gjatë fazave të parashikuara me Ligj.*
4. *Vendimet preliminare të Organit shpronësues duhet të përmbajnë arsyetimin për ligjshmërinë e qëllimit të shpronësimit.*
5. *Vendimet e organeve shpronësuese duhet të jenë me gjuhë të qartë, të saktë dhe të përmbajnë të gjithë elementët që kërkohen nga Ligji.*
6. *Ministritë përkatëse dhe komunat, që në fillim të procedurave të shpronësimit të zhvillojnë konsultime paraprake me komunitetin që tangojnë nga shpronësimet, duke u bazuar në standardet dhe përvojat ndërkombëtare.*

5. Të ndryshme

Çështje vijuese

a) Kërkesa e sindikatës së KEK-ut

Visar Ymeri – Pyeti kryetarin e Komisionit se mos ka ardhur ndonjë kërkesë nga sindikata e Korporatës Energjetike e Kosovës.

Kryetari – Tha se deri më tani nuk ka ardhur ndonjë kërkesë nga ana e sindikatës së KEK-ut.

b) Prodhimet vendore

Ramiz Kelmendi – I ftoi të gjithë anëtarët e Komisionit në promovimin e prodhimeve vendore që do të bëhet në Korporatën ETC, më 21 shkurt në Fushë- Kosovë.

Kryetari – Kërkoi që me këtë datë, të organizohet Komisioni dhe t'i ftojë të gjithë deputetët që dëshirojnë të marrin pjesë.

c) Vizitat te agjencitë e pavarura

Kryetari - Propozoi që të hartohet një draft-agjendë nga stafi i Komisionit për vizita në institucionet, të cilat i mbikëqyrë Komisioni Funkcional.

Mbledhja përfundoi në orën 13:00.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Zenun Pajaziti

Kryetar i Komisionit